



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS  
ALBANIA



# **Vlerësimi i zbatimit të *Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik për Personat me Aftësi të Kufizuara Intelektuale* nga institucionet vendore**



Leave  
No One  
Behind

# Vlerësimi i zbatimit të *Ligji i* *Njoftimit dhe Konsultimit Publik* *për Personat me Aftësi të Kufizuara* *Intelektuale nga institucionet* *vendore*

Ky raport u hartua nga shoqata *Ndihmoni Jetën* me ndihmën e UNDP-së, si pjesë e projektit “Të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale mbrojnë të drejtat e tyre”, ndërmarrë në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së “Askush të mos mbetet pas/*Leave No One Behind*” (LNB2), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk janë domosdoshmërisht ato të UNDP-së apo Kombeve të Bashkuara (UN).

Dokumenti “Vlerësimi i zbatimit të *Ligjit për Informimin dhe Konsultimin Publik për Personat me Aftësi të Kufizuara, Intelektuale nga institucionet vendore*” u hartua me asistencën e Prof. Asoc. Dr. Rudina Rama.

# Tabela përmbajtjes

|                                                                                                                                   |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Parathënie .....</b>                                                                                                           | <b>5</b>  |
| <b>Përmbledhje ekzekutive.....</b>                                                                                                | <b>7</b>  |
| <b>Hyrje .....</b>                                                                                                                | <b>12</b> |
| Qëllimi dhe objektivat .....                                                                                                      | 14        |
| <b>Metodologjia .....</b>                                                                                                         | <b>16</b> |
| Pjesëmarrësit në studim dhe kampioni .....                                                                                        | 16        |
| Instrumentet për mbledhjen e të dhënave .....                                                                                     | 17        |
| Analiza e të dhënave .....                                                                                                        | 19        |
| <b>Gjetje dhe rezultate .....</b>                                                                                                 | <b>20</b> |
| Vështrim i kuadrit ligjor me fokus rolin e<br>qeverisjes vendore .....                                                            | 20        |
| Njoftimi, konsultimi dhe informimi publikut<br>në qeverisjen vendore .....                                                        | 22        |
| Zbatimi i ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik<br>nga perspektiva e institucioneve vendore dhe<br>palëve të interesit. .... | 26        |
| <b>Përfundime dhe rekomandime .....</b>                                                                                           | <b>36</b> |
| <b>Referenca .....</b>                                                                                                            | <b>40</b> |
| <b>Shtojca .....</b>                                                                                                              | <b>42</b> |





# Parathënie

---

Në vitet e fundit, Shqipëria ka dërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e të drejtave dhe përfshirjes të personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Një nga ndryshimet kryesore në këtë drejtim është LIGJ Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili synon të sigurojë pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, nga e cila rrjedh e drejta e personave me aftësi të kufizuara intelektuale, të kanë qasje të barabartë në informacion dhe mundësinë për të marrë pjesë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.

Ky studim ka dy qëllime kryesore. Së pari, synon të vlerësojë nëse Ligji “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, është zbatuar në mënyrë efektive, duke marrë në konsideratë nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara intelektuale në Shqipëri. Së dyti, synon të ofrojë rekomandime për përmirësimin e zbatimit të këtij ligji, duke siguruar kështu pjesëmarrjen më të gjerë, përfshirjen dhe fuqizimin e kësaj kategorie.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti i drejtohen një audience të gjerë:

- Politikbërësit dhe Përfaqësuesit vendor: Duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara, bazuar në studime për të përmirësuar jetën e personave me aftësi të kufizuara intelektuale.
- Grupet Vet-Advokuese dhe OJF: Organizatat që punojnë për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të

kufizuara intelektuale mund të përdorin rekomandimet e raportit për të advokuar për ndryshimet e nevojshme në politikën dhe praktikën aktuale.

- Komuniteti i gjerë: Ngritja e ndërgjegjësimit rreth sfidave që përballen personat me aftësi të kufizuara intelektuale është e rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie gjithpërfshirëse. Raporti mund të ndihmojë në edukimin e publikut të gjerë rreth këtyre çështjeve.

Duke hedhur dritë mbi gjendjen e tanishme të raportit për zbatimin e Ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Personat me Aftësi të Kufizuara Intelektuale” nga institucionet vendore, raporti hap rrugën për përmirësime në vendim marrje, politikbërie dhe nismave që promovojnë përfshirjen, barazinë dhe realizimin e të drejtave themelore të persoanve me aftësi të kufizuara.

## Përmbledhje ekzekutive

Zbatimi i *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik* është një sfidë komplekse dhe është ndër çështjet që po përjeton ndryshime si rezultat i zhvillimeve të ndryshme politike, shoqërore dhe teknologjike. Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e konsultimit publik mbetet një çështje kritike, ndërkohë shtrohen paqartësi, nëse ekzistojnë mekanizma efektivë për të dëgjuar dhe për të marrë parasysh opinionet e tyre. Ndryshimet teknologjike kanë ndikuar në mënyrën se si njoftimi dhe konsultimi publik kryhet, ndaj përdorimi i teknologjisë për t'i bërë proceset më të efektshme dhe të qasshme është i rëndësishëm, por pa lënë mënjane ato grupe, të cilat kanë burime dhe akses të kufizuar në këtë drejtim. Është kritike që institucionet përgjegjëse për njoftimin dhe konsultimin publik të kenë pavarësi dhe burime të mjaftueshme për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe të profesionalizuar. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe me shoqërinë civile mund të jenë mekanizma të rëndësishëm për të përmirësuar proceset e konsultimit publik dhe për ta përfshirë më shumë opinionin publik. Gjithashtu, vlerësohet të sigurohen mekanizma të vazhdueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të konsultimit publik, për të identifikuar sfidat dhe për të bërë ndryshime dhe për të ndërhyrë në rast nevojë. Paralelisht, vlerësohet e rëndësishme të sigurohet që njoftimi dhe konsultimi publik të jetë i qasshëm dhe i përshtatshëm për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe grupet e tjera, të veçanta. Këto grupe shpesh hasin vështirësi dhe barriera të ndryshme për t'u dhënë zë shqetësimeve të tyre dhe për t'u përfshirë në mënyrë



aktive në proceset vendimmarrëse, me qëllim krijimin e një baze ligjore dhe politike, që garanton respektimin e të drejtave të tyre, bazuar në nevoja reale. Për të eksploruar më thellë rolin e institucioneve vendore dhe palëve të interesit në procesin e zbatimit të *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik*, ky raport ka për qëllim që të vlerësojë në mënyrë kritike strategjitë, efektivitetin, sfidat dhe rezultatet që lidhen me zbatimin në nivel lokal të *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik* për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale nga perspektiva e institucioneve dhe palëve të interesit.

Për të përmbushur qëllimin e vlerësimit u përdor metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave, nëpërmjet së cilës u hulumtua kuadri ligjor dhe rregullator dhe më pas u mbledhën të dhëna parësore nëpërmjet 28 intervistave të kryera me profesionistë nga institucionet vendore, përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar, prindër, kujdestarë dhe të rinj me aftësi të kufizuara në bashkitë Durrës, Tiranë dhe Vlorë.

*Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik* është i njohur nga profesionistët e institucioneve vendore, por paraqitet e nevojshme ndërmarrja e hapave për një zbatim më të plotë, të thellë dhe efikas të tij. Organizatat, që operojnë për dhe me personat me aftësi të kufizuara, e njohin ligjin, por konsiderojnë se zbatimi i tij nga institucionet ende nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë objektivin e tij. Ndërkohë, prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara ndjehen të painformuar dhe të papërfshirë, duke theksuar një nevojë të madhe për pjesëmarrje dhe angazhim aktiv në proceset që i prekin ata.

Ndërsa burimet elektronike përbëjnë një mjet kyç për informimin dhe konsultimin e projekt-akteve ligjore, rregullatore dhe politike, aksesueshmëria dhe teknologjia nuk janë gjithmonë të përshtatshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe prindërit e tyre, veçanërisht për ata me kufizime financiare apo teknologjike. Kjo situatë thellon

më tej hendekun e angazhimit dhe pjesëmarrjes së tyre.

Një tjetër sfidë është mungesa e përfaqësimit dhe e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në zonat e Durrësit dhe të Vlorës, ku vihet në dukje mosekzistenca e organizatave lokale që t'i përfaqësojnë. Në gjykimin e palëve të interesit kjo situatë ka përshkallëzuar angazhimin e ulët të pjesëmarrjes dhe të mosqenit të dëgjuar.

Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë shprehin interes për angazhimin në proceset e konsultimit publik, por shprehën të pasigurt dhe pa besim në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kuptuar dhe për të zbërthyer projekt-dokumentet, por edhe për të artikuluar dhe për të adresuar si duhet kërkesat dhe shqetësimet e tyre.

Për t'i adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, është i nevojshëm një angazhim i gjerë nga të gjitha palët e përfshira. Kjo përfshin edukimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve, shtimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave, dhe krijimin e strategjive të komunikimit, që janë më të përshtatshme dhe të arritshme për të gjithë. Gjithashtu, paraqitet e rëndësishme që të punohet në thellimin e transparencës dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve për t'i bërë proceset më efikase dhe të drejta. Për këtë qëllim është e nevojshme ndërhyrja ligjore, investimet në kapacitete institucionale dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e rolit të tyre në këto procese.

## Përmbledhje ekzekutive në format të thjeshtëzuar

Zbatimi i ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik është një çështje e rëndësishme por komplekse. Ky ligj është në ndryshim për shkak të zhvillimeve politike, shoqërore, dhe teknologjisë.

Për shumë njerëz, është vështirë të marrin pjesë në këto procese dhe nuk është e qartë se si ata mund të japin mendimet e tyre. Teknologjia është e rëndësishme për të bërë këto procese më efikase, por duhet të kujdesemi që të gjithë, përfshirë ata me kufizime dhe burime të kufizuara, të kenë qasje në to.

Institucionet që janë përgjegjëse për njoftimin dhe konsultimin publik duhet të jenë të pavarura dhe të kenë burime të mjaftueshme. Bashkëpunimi me organizatat dhe shoqërinë civile është një mënyrë e mirë për të përmirësuar këto procese dhe për të përfshirë më shumë opinionin publik.

Është gjithashtu e rëndësishme të monitorojmë dhe vlerësojmë proceset e konsultimit publik për të kuptuar problemet dhe bërë ndryshime nëse është e nevojshme. Po ashtu, duhet të sigurojmë që këto procese janë të qasshme për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, minoritetet, dhe grupet e tjera të veçanta.

Raporti është bërë duke përdorur intervista dhe lexuar studime për të kuptuar se si ligji i njoftimit dhe konsultimit publik funksionon për personat me aftësi të kufizuara intelektuale në nivelet vendore. Ligji njihet nga profesionistët, por ka nevojë për zbatim më të mirë. Organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuara e njohin ligjin, por mendojnë se institucionet nuk e zbatuan atë në mënyrë të mjaftueshme.

Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara ndihen të pa-informuar dhe të papërfshirë në këto procese. Burimet elektronike janë të rëndësishme, por nuk janë gjithmonë të përshtatshme për këto grupe.

Një problem tjetër është mungesa e përfaqësimit dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në disa zona. Prindërit dhe kujdestarët duan të marrin pjesë, por ndjehen të pasigurtë në aftësitë e tyre për të kuptuar dokumentet dhe për të shprehur kërkesat e tyre.

Për të përmirësuar këto çështje, duhet të edukojmë të gjithë aktorët, të rrisim bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizatave, dhe të ndihmojmë qytetarët të jenë më të përfshirë. Po ashtu, është e rëndësishme të ndërmerren hapa ligjorë dhe të investohet në kapacitete institucionale për të përmirësuar këto procese.

# Hyrje

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD, 2006) thekson rëndësinë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse, duke siguruar të drejtat e tyre për të marrë pjesë në jetën publike dhe për të pasur akses në informacion. Qasja e hartimit të kuadrit rregullator dhe politik me pjesëmarrje mundëson nxitjen e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe siguron që politikat dhe ligjet të hartohen, duke marrë parasysh nevojat dhe perspektivat specifike të personave me aftësi të kufizuara, por jo vetëm.

Që politikat të jenë vërtet gjithëpërfshirëse, është e domosdoshme që të sigurohet pjesëmarrja *aktive* e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat dëgjimore dhe konsultimet publike. Ligjet, që promovojnë aksesin ndaj informacionit dhe konsultimin publik, janë një hap në drejtimin e duhur, por zbatimi dhe vlerësimi i tyre, i suksesshëm varet nga adresimi i barrierave, me të cilat përballet ky grup dhe qëllimi që ligji të përmbushë misionin e tij.

Si shumë vende të tjera, edhe Shqipëria ka zhvilluar kornizën ligjore dhe dispozita, që mandatojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në dëgjесat publike dhe zhvillimin e politikave.

Pavarësisht mandateve ligjore, zbatimi i politikave dhe praktikave, që lehtësojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale, paraqitet të jetë sfidues. Studimet nxjerrin në pah pengesa të tilla si mungesa e ndërgjegjësimit, burimet e pamjaftueshme dhe barrierat e qëndrimit midis

politikë-bërësve, të cilat pengojnë zbatimin efektiv. Gjithashtu, *Whyte, A., & Brodsky, A. (2018)* diskutojnë se si personat me aftësi të kufizuara, intelektuale përballen me sfida specifike në aksesin e informacionit dhe përfshirjen në proceset e zhvillimit të politikave, për shkak të dëmtimeve konjitive, vështirësive të komunikimit dhe paragjyqimeve shoqërore.

Sigurimi, që informacioni dhe metodat e komunikimit të jenë të aksesueshme për individët me aftësi të kufizuara, intelektuale, është një aspekt kritik i pjesëmarrjes së suksesshme. Studimet kanë eksploruar përdorimin e materialeve të lexueshme, metodave alternative të komunikimit dhe teknologjisë së aksesueshme, për të lehtësuar përfshirjen e tyre. *Smith, E. L. (2020)* fokusohet në mënyrën se si të bëhet informacioni i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale, duke theksuar rëndësinë e formateve lehtësisht të lexueshme, ndihmave vizuale dhe komunikimit të përshtatur. Për të vënë në dukje rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në dëgjesa publike dhe në proceset e tjera të vendimmarrjes, *Turner, B. (2019)* ndërmori shqyrtimin e raste studimore, ku këta persona kanë qenë të përfshirë në mënyrë aktive në konsultimet e politikave, duke vënë në dukje, si sukseset, ashtu edhe fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Ndërkohë, *Clark, M., & Murphy, G. (2017)* theksojnë nevojën për politika, që kujdesen për nevojat arsimore dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale. Përfshirja e tyre në procesin e konsultimit siguron që këto politika t'i u përshtaten nevojave që ata kanë.

Studime të tjera kanë theksuar rëndësinë e programeve të trajnimit dhe të ndërgjegjësimin për politikëbërësit, për zyrtarët qeveritarë dhe për publikun. Programet e trajnimit mund të ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve për t'u angazhuar në mënyrë efektive me personat me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe për të ofruar kanale të aksesueshme informacioni dhe

komunikimi. *Davies, R. T., & Jenkins, R. (2021)* ofrojnë strategji për rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat dhe konsultimet publike, duke përfshirë trajnimin, përdorimin e teknologjisë dhe krijimin e mjediseve mbështetëse.

Hulumtimi mbi ndikimin e politikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse ka demonstruar rezultate të përmirësuara për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale, duke përfshirë akses më të mirë në shërbime, rritje të përfshirjes sociale dhe politika më të përgjegjshme, që adresojnë nevojat e tyre, specifike.

Studiues të ndryshëm dhe ekspertë të fushës sugjerojnë që hulumtimet e ardhshme në këtë spektër mund të fokusohen në vlerësimin e ndikimit afatgjatë të kornizave ligjore, zhvillimin e udhëzimeve të standardizuara për konsultimin publik, gjithëpërfshirës dhe eksplorimin e teknologjive dhe metodave novatore për të rritur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale.

---

## Qëllimi dhe objektivat

---

Të vlerësojë në mënyrë kritike strategjitë, efektivitetin, sfidat dhe rezultatet, që lidhen me zbatimin në nivel lokal të *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për Personat me Aftësi të Kufizuara, Intelektuale* nga perspektiva e institucioneve dhe e palëve të interesit.

### **Objektivat:**

Të analizojë bazën ligjore dhe rregullatore, që garanton përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale.

Të kuptojë përgjegjësitë, njohuritë, rolin dhe sfidat specifike të të intervistuarve në lidhje me zbatimin e *Ligjit të Njoftimit dhe*

*Konsultimit Publik për Personat me Aftësi të Kufizuara, Intelektuale.*

Të eksplorojë strategjitë e përdorura në nivel lokal për të nxitur pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara intelektuale në dëgjesat publike dhe në formulimin e politikave.

Të identifikojë natyrën e bashkëpunimeve ndërmjet pushtetit vendor, subjekteve joqeveritare dhe palëve të tjera të interesit me fokus zbatimin e *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik*.



# Metodologjia

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e vlerësimit u përdor metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave. Faza e parë e studimit u karakterizua nga procesi i rishikimit të literaturës dhe analizës së dokumenteve të ndryshme të kuadrit ligjor dhe administrativ në lidhje me fokusin e vlerësimit. Këtu përfshihet *Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Ligji për të Drejtën e Informimit, Ligji i Vetëqeverisjes Vendore, Ligji i Aksesueshmërisë* etj. Gjithashtu, me qëllim kuptueshmërinë e situatës në një rrafsh më të gjerë u ndërmor një analizë e studimeve të ndryshme me të njëjtin fokus në vende të ndryshme. Gjithashtu, në procesin e rishikimit të literaturës i është kushtuar vëmendje modeleve të studimeve relevante dhe bashkëkohore, të cilat kanë shërbyer për të hedhur dritë në përmbajtjen e instrumenteve të studimit, analizës së të dhënave, diskutimit dhe rekomandimeve. Nënçështjet në vijim pasqyrojnë në mënyrë të përmbledhur hapat e mëtejshëm të vlerësimit.

---

## Pjesëmarrësit në studim dhe kampioni

---

Në fokus të vlerësimit ishin profesionistë nga institucione vendore dhe nga organizata, që punojnë me dhe për aftësinë e kufizuar në Durrës, në Tiranë dhe në Vlorë; të rinj me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe familjarë, kujdestarët e tyre nga të njëjtat bashki. Për të mundur mbledhjen e të dhënave për përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të vlerësimit u përdor metoda e kampionit të qëllimshëm, duke mbajtur në konsideratë vitet e përvojës profesionale në institucion, jo më

pak se tre vite për profesionistët dhe të rinjtë, si dhe prindërit e tyre të ishin rezidentë prej jo më pak se tre vitesh në bashkitë respektive. Në vlerësim u përfshinë në total 28 pjesëmarrës, nga të cilët, 11 profesionistë nga institucionet vendore në Tiranë, në Durrës dhe në Vlorë, 3 profesionistë nga shoqatat e aftësisë së kufizuar, 5 të rinj me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe 9 prindër, kujdestarë të të rinjve me aftësi të kufizuara, intelektuale.

---

## Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

---

Për mbledhjen e të dhënave u përdor intervista gjysmë e strukturuar për secilin grup pjesëmarrësish të përfshirë në vlerësim, përkatësisht përfaqësuesit e institucioneve vendore, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe prindërit e kujdestarët e tyre.

Udhëzuesi i intervistës me përfaqësuesit e institucioneve vendore mbulon aspekte të ndryshme të zbatimit të *Ligjit të Informimit Publik*, duke përfshirë rolet dhe strategjitë e vendosura, metodat e komunikimit për aksesin, vlerësimin e efektivitetit, ndikimin në zhvillimin e politikave, trajnimin e palëve të interesuara, mekanizmat e reagimit, adresimin e sfidave dhe rezultatet e monitorimit. Për më tepër, intervista synon të nxjerrë në pah historitë e suksesit ose fushat e përmirësimit, që rezultojnë nga zbatimi i ligjit.

Udhëzuesi i intervistës për përfaqësuesit e organizatave të aftësisë së kufizuar starton me mbledhjen e informacionit mbi misionin, objektivat, kohëzgjatjen e funksionimit dhe fushat e shërbimit të saj. Më pas fokusohet në vlerësimin e njohjes së *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik* dhe si janë informuar në lidhje me këtë ligj dhe ligje të tjera me interes për organizatën. Pyetjet vijojnë me vlerësimin e perceptimit të

ligjit nga vetë organizata dhe personat me aftësi të kufizuara, duke u thelluar më tej me eksplorimin e angazhimit të organizatës në proceset e konsultimit publik dhe sfidat e barrierat e përballuara. Zbatueshmëria e ligjit dhe përpjekjet e organizatës për përmirësimin e tij përbëjnë disa pyetje, duke e mbyllur intervistën me rekomandime të mundshme dhe duke iu kërkuar pjesëmarrësve që të ndajnë çdo njohuri ose perspektivë shtesë mbi temën në fjalë.

Udhëzuesi i intervistës për prindërit, për kujdestarët e të rinjve me aftësi të kufizuara, intelektuale synon që të vlerësojë njohjen dhe të thellohet në mënyrën e prezantimit me *Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*. Më tej intervista fokusohet në të kuptuarin dhe këndvështrimin e tyre mbi rëndësinë e ligjit dhe qasjen e institucioneve të pushtetit vendor ndaj të drejtave të aftësisë së kufizuar. Në intervistë vëmendje i kushtohet përvojës së tyre (ose mungesës) me proceset e konsultimit publik në lidhje me projekt-aktet, rregulloret dhe politikat, barrierat, me të cilat përballen dhe mënyrat e preferuara të përfshirjes në konsultime të tilla. Një fokus i rëndësishëm është vlerësimi i perceptimit mbi efektivitetin e institucioneve vendore mbi zbatimin e dispozitave ligjore. Gjithashtu, intervista synon të kuptojë rezultatet apo përmirësimin nga zbatimi i ligjit dhe mbledhjen e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e procesit të konsultimit.

Udhëzuesi i intervistës për të rinjtë me aftësi të kufizuara është hartuar dhe është përshtatur me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale. Fillimisht synohet krijimi i raporteve me të rinjtë, për t'u siguruar që ata të ndihen të sigurt, rehat dhe të vlerësuar. Më tej synohet të mbledhet informacion mbi njohuritë, vetëdijen dhe përvojat e tyre në lidhje me metodat që institucionet vendore i mbështesin, i dëgjojnë, bisedojnë apo vendosin marrëdhënie me të rinjtë, për të hartuar ligje, rregulla dhe

politika bazuar në nevojat e tyre, reale. Gjithashtu, intervista synon që t'i identifikojë sfidat e hasura, të zbulojë mënyrat e tyre, të preferuara për të marrë pjesë, për t'u shprehur, duke u fokusuar edhe në sugjerime apo këshilla se si ata mund të angazhohen më mirë në konsultime publike.

Procesi i mbledhjes së të dhënave u realizua në periudhën korrik-gusht, duke respektuar të gjitha parimet etike të privatësisë dhe konfidencialitetit të një kërkimi.

---

## **Analiza e të dhënave**

---

Procesi i intervistimit u krye, duke mbajtur shënime gjatë intervistës, me dakordësinë e intervistuesve. Më pas të dhënat u zbardhën dhe u printuan për ta lehtësuar procesin e analizës së të dhënave dhe përcaktimit të temave kryesore. Mënyra kryesore e analizës së të dhënave u krye nëpërmjet analizës së përmbajtjes, e cila shërbeu gjithashtu për të përcaktuar tematikat kryesore dhe analizën krahasuese të çështjeve.

# Gjetje dhe rezultate

---

## Vështrim i kuadrit ligjor me fokus rolin e qeverisjes vendore

---

Kornizat ligjore nuk janë thjesht përshkrime statutore, ato shërbejnë për të siguruar rrugën drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe empatike. Veçanërisht për individët me aftësi të kufizuara, intelektuale këto korniza ndërtojnë themelet për realizimin e të drejtave të tyre dhe sigurimin e pjesëmarrjes aktive në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimin e politikave.

Në Shqipëri nga viti 2014 është hartuar dhe miratuar kuadri ligjor, që mundëson rregullimin e marrëdhënieve të konsultimit publik, transparent dhe gjithëpërfshirës ndërmjet organeve publike, qendrore, vendore dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të projekt-akteve ligjore dhe politikave me interes të lartë, publik.

### Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik

Konsultimi publik është tërheqja e mendimeve dhe e sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt-aktit, nga momenti i publikimit deri në miratimin e tij, përfundimtar.

*Ligji 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik* ka si qëllim rregullimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik për projektligjet, dokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, dhe politikat me interes të lartë, publik. Ai synon nxitjen e

transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Ligji jep definicionin e një vargu termash, si “Akt administrativ, individual”, “Emergjencë civile”, “Grup interesi”, “Konsultim publik”, “Njoftim paraprak”, “Njoftim publik”, “Organ publik” etj. Ky ligj zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit dhe të konsultimit publik nga organet publike. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet si çështjet e sigurisë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare, aktet administrative, individuale etj.

Sipas ligjit, organet publike duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe të palëve të interesuara. Ato janë të detyruara që të publikojnë të dhëna dhe informacione të caktuara, si dhe të organizojnë konsultime dhe takime publike me palët e interesuara.

Neni 7 i ligjit thekson krijimin e një *Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike*. Qëllimi i tij është të sigurojë akses për të gjitha palët e interesuara për të komunikuar me organet publike. Regjistri elektronik ndihmon në ofrimin e një aksesit të barabartë në informacion dhe shërbim për të gjithë, duke marrë parasysh edhe nevojat e ndryshme të grupeve të caktuara të njerëzve.

Ligji përcakton se cilat janë palët e interesit dhe trajton të drejtat e tyre, si e drejta për të marrë informacion mbi njoftimet dhe konsultimet, të propozojnë nisma të reja dhe të paraqesin komente dhe rekomandime. Një element shumë i rëndësishëm i ligjit është kërkesa që

çdo organ publik duhet të caktojë një person, që do t'i koordinojë njoftimet dhe konsultimet publike.

Ndërkohë, një sërë nenesh, konkretisht 11-19, trajtojnë rregullat dhe procedurat specifike për njoftimin dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, përfshirë mënyrat e njoftimit, afatet kohore, format e komunikimit, si dhe pjesëmarrjen në

takime publike.

Pas miratimit të ligjit, proces i rëndësishëm është hartimi i akteve nënligjore, që detajojnë dhe zbatojnë dispozitat e ligjit. Në rastin e *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik* këto akte përcaktojnë funksionimin e regjistrit elektronik, procedurat për dorëzimin e kërkesave, formatin e përgjigjeve, tarifrat (nëse ka), dhe sanksionet për moszbatim.

---

## **Njoftimi, konsultimi dhe informimi i publikut në qeverisjen vendore**

---

Krahas procesit të njoftimit dhe konsultimit publik për projekt-akte, politika dhe rregullore të ndryshme, pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit dhe e palëve të interesit në vendimmarrje parashikohet edhe në *Ligjin e Informimit Publik* dhe në *Ligjin e Vetëqeverisjes Vendore*. Bashkitë, sipas kuadrit ligjor, janë të detyruara që të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes dhe që të caktojnë Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Në nivel vendor Këshilli Bashkiak dhe kryetari i bashkisë duhet që të sigurojnë njoftimin mbi konsultimin publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të projekt-aktit të njoftimit për konsultim, publikimin në Programin e Transparencës, dhënien e informacionit në të gjitha fazat e konsultimit publik, organizimin e takimeve konsultative dhe takimeve publike me palët e interesuara.

Konkretisht, mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun, ku çdo qytetari i lejohet të ndjekë mbledhjet e Këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e Këshillit. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga Këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Vendimmarrja e Këshillit ndahet në vendimmarrje me ose pa

konsultim publik dhe vendimmarrje, sipas pjesëmarrjes së këshilltarëve në votim. Aktet e Këshillit Bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga Këshilli me akses të lirë, publik, brenda territorit të njësisë dhe, sipas mundësive, Këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Ato shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre të subjekteve që përfshihen në to.

*Ligji i ri Nr. 135/2015 për Vetëqeverisjen Vendore*, i miratuar në dhjetor 2015, i kushton katër nene të veçanta strukturave komunitare, përfshirë këtu ndërlidhësin komunitar, këshillin, kryetarin e fshatit dhe kryesinë e fshatit. Misioni i strukturave komunitare është jetësimi i demokracisë pjesëmarrëse përmes fuqizimit, organizimit dhe mobilizimit të qytetarëve për çështje që kanë rëndësi themelore për ta. E Drejta e Iniciativës Qytetare për të propozuar dhe për të hartuar politika është një mekanizëm tjetër, që fuqizon komunitetin për të vepruar dhe për t'i ndryshuar politikat në bashkitë përkatëse.

Sipas nenit 20 të *Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore*, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, të autorizuar, ose jo më pak se 1% e banorëve të bashkisë, ka të drejtë të paraqesë për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Propozimet e ardhura në Këshillin Bashkiak si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në Këshill sipas rendit të ditës dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin



e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Peticioni është një mekanizëm i rëndësishëm i demokracisë pjesëmarrëse, pasi inicohet nga publiku, në dallim me informimin dhe konsultimin publik, që janë detyra të bashkisë.

E drejta e petitionit është e parashikuar në kapitullin e lirive politike në nenin 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'i drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Çdo person apo organizatë, përfshirë ato të aftësisë së kufizuar, me interes në një bashki të caktuar ka të drejtën e hartimit dhe të nënshkrimit të petitionit drejtuar Këshillit Bashkiak për çdo çështje që lidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e bashkisë. Pas pranimit të petitionit, Këshilli Bashkiak e shqyrton atë, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren e tij të punës.

Sipas nenit 19 të *Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore*, çdo qytetar apo grupe qytetarësh, që përfaqësojnë komunitetet lokale kanë të drejtë t'iu drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

E drejta për informim është e drejta e çdo qytetari për t'u njohur me informacionin publik, e garantuar ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe *Ligji Nr.119/2014 për të Drejtën e Informimit*, i cili synon nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Për të pasur një qeverisje lokale të mirë dhe demokratike transparenca përbën një nga elementet thelbësore, që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët. Ajo nënkupton

ndarjen e informacionit, si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun.

Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar nga institucionet publike në çfarëdolloj forme e formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht se kush ka qenë autoriteti që e ka përgatitur atë. Çdo qytetar ka të drejtë të ketë akses në informacionet zyrtare, pavarësisht nëse i duhet për veten e tij apo për një person të tretë.

Bashkia duhet të publikojë Programin e Transparencës në faqen e saj, zyrtare dhe në stendat pranë mjediseve të saj, fizike, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Bashkia cakton një nëpunës si Koordinator për të Drejtën e Informimit, i cili mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe iu kthen përgjigje qytetarëve në kohë.

Për herë të parë në këtë ligj parashikohen sanksione administrative dhe përgjegjësi individuale ndaj titullarëve të institucioneve dhe nëpunësve të ngarkuar me përgjegjësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në rast të verifikimit nga Komisioneri të shkeljes së të drejtës për informim, aplikohen gjoba të drejtpërdrejta ndaj kryetarit të bashkisë dhe Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Gjithashtu, ligji parashikon përgjegjësi direkte ndaj zyrtarëve që refuzojnë të japin informacionin e kërkuar. Komisioneri është institucioni përgjegjës për trajtimin dhe verifikimin e ankesave për shkelje të së drejtës së informimit. Në rast të verifikimit nga Komisioneri të shkeljes së të drejtës për informim, aplikohen gjoba të drejtpërdrejta ndaj titullarit të institucionit, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit apo për çdo nëpunës përgjegjës për mosdhënie informacioni.

Bashkitë kanë përgjegjëshmëri për të hartuar dhe për të publikuar raportin vjetor të transparencës, i cili përmban informacion mbi numrin e akteve të miratuara gjatë vitit referues; numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra

nga palët e interesuara; numrin e rekomandimeve dhe të komenteve të pranuar e të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; numrin e takimeve të organizuara, publike.

Këshilli Bashkiak zhvillon seanca këshillimi me qytetarët vendorë, që janë të detyrueshme, në rastet kur lidhen me çështje të tilla si zgjedhja e komisioneve të Këshillit, miratimi i buxhetit dhe ndryshimi i tij, miratimi për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave palëve të treta, miratimi i normave, standardeve dhe kritereve për rregullimin dhe menaxhimin e funksioneve të decentralizuara ose të deleguara me ligj nga qeveria.

Dialogu dhe këshillimi për çështje të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe social angazhon qytetarët dhe komunitetet në diskutime të informuara rreth qëllimeve dhe prioritetëve të zhvillimit lokal.

Këshillimi me publikun bëhet sipas rregullores së Këshillit dhe mund të jetë në formën e takimeve të hapura me banorët dhe grupet e interesit, takime me specialistë, institucione të interesuara dhe organizata të shoqërisë civile ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

---

## **Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik nga perspektiva e institucioneve vendore dhe e palëve të interesit**

---

*Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik* nuk njihet mjaftueshëm nga profesionistët pranë qeverisë vendore, ata posedojnë një informacion të përgjithshëm mbi rëndësinë e konsultimit të dokumenteve, mjediset dhe mënyrat e publikimit të tyre, por nuk posedojnë informacion të qartë në lidhje me regjistrin elektronik, personin e kontaktit për konsultimin publik, mënyrat alternative të njoftimit dhe konsultimit, njoftimin paraprak apo çështje të tjera më specifike.

Procesi më shumë orientohet nga konsultimi i draft-dokumenteve, se sa nga njoftimi paraprak për hartimin e ligjit (pa u përgatitur projekt-dokumenti i parë), që palët e interesit t'i dërgojnë apo t'i adresojnë shqetësimet e tyre, në mënyrë që të merren në konsideratë paraprakisht. Situata paraqitet disi më ndryshe në rastet e hartimit të dokumenteve politike, si strategjitë lokale apo planet e veprimit për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë rast organizatat dhe palët e tjera të interesit bëhen pjesë e procesit të vlerësimit të nevojave, përpara se të hartohet projekt-dokumenti i parë i planit strategjik dhe planit të veprimit. Por, në këtë rast ata shprehen se, edhe pse dokumentet i adresojnë nevojat e tyre, zbatueshmëria, sidomos për shërbimet, paraqitet shqetësuese.

### **Burimi i informacionit**

Format më të shpeshta të njoftimit janë regjistri elektronik dhe komunikimi nëpërmjet postës elektronike. Reagimet në regjistrin elektronik pothuajse mungojnë, shumë prej pjesëmarrësve në trajnim nuk janë në dijeni të tij dhe mbajnë një qëndrim dyshues për efektivitetin e tij. Ndërkohë, përfaqësuesit e institucioneve pohojnë se ata i njoftojnë organizatat dhe vendosin njoftime pranë qendrave komunitare apo shërbimeve të tjera, publike, që frekuentojnë personat me aftësi të kufizuara. Në këtë këndvështrim prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë pohojnë se ata nuk kanë marrë njoftim dhe do preferonin mënyra më të drejtpërdrejta dhe sqaruese. Disa prej tyre ndanë përvojën, kur janë thirrur në lidhje me procesin e buxhetimit, por, edhe pse kishin qenë të pranishëm, nuk kishin mundur të kuptonin rolin e tyre dhe kontributin që mund të ofronin apo çështje që mund të adresonin. Disa prej pjesëmarrësve në vlerësim shprehen se, nëse do të kishin informacion, do të merrnin pjesë, por në të njëjtën kohë paraqesin dyshime dhe pasiguri për cilësinë e kontributit të tyre në këtë proces dhe

pasigurinë për vërtetësinë dhe transparencën e procesit. Një pjesë e konsiderueshme e prindërve, pavarësisht dëshirës për të qenë më aktivë, ndajnë shqetësimin për mungesën e kohës dhe mundësisë për t'u përfshirë në këto iniciativa, pasi, për shkak të nevojës, iu duhet të punojnë për të siguruar të ardhura dhe pjesën e mbetur të kohës duhet të kujdesen për fëmijët.

## **Edukimi dhe trajnimi**

Shpesh garantimi i zbatimit të suksesshëm të kuadrit rregullator, krahas hartimit dhe miratimit me pjesëmarrje, kërkon edhe një proces sensibilizimi, edukimi dhe trajnimi të aktorëve që do ta zbatojnë dhe atyre që përfitojnë apo preken nga zbatueshmëria e tij.

Nga intervistat rezulton se profesionistët në institucionet e qeverisjes vendore, profesionistët e organizatave të aftësisë së kufizuar dhe palët e interesit (prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale) nuk janë përfshirë dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë proces formal edukimi, trajnimi, që lidhet me njohuritë bazë apo specifike të *Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*, pavarësisht se të gjithë pjesëmarrësit raportojnë për pjesëmarrje në trajnime, që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ata theksojnë se gjatë trajnimeve kanë diskutuar çështjen e rëndësisë së pjesëmarrjes dhe përfshirjes në procese vendimmarrëse, por bëjnë me dije se nuk janë fokusuar në bazën ligjore, apo nuk janë prezantuar, për shembull, me regjistrin elektronik, Koordinatorin e institucionit për Konsultimin Publik, ekzistencën e vendeve specifike ku shpallen njoftimet për këto çështje, apo teknika dhe metoda të dedikuara për zbatimin e kësaj baze ligjore. Palët e interesit theksuan që, edhe nëse do ta kishin këtë informacion, ata do të kishin nevojë që të merrnin trajnime specifike dhe të asistoheshin për të kuptuar përmbajtjen e tyre, si të formulojnë si duhet mendimet, sugjerimet apo të artikulojnë saktë dhe

qartë shqetësimet, nevojat dhe kërkesat. Ata theksuan se shërbimet për të rinjtë me aftësi të kufizuara janë pothuajse të munguara dhe se e kanë urgjente, që kërkesat e tyre të jenë të reflektuara dhe të artikuluara, bazuar në nevojat e tyre, reale.

Trajnimi është një mjet i rëndësishëm për t'i ndihmuar nëpunësit publikë dhe palët e tjera të interesuara që të kenë një kuptueshmëri të thellë të bazës ligjore dhe që të jenë të përgatitur për të ofruar mbështetje, shërbime, angazhim dhe pjesëmarrje efektive të të gjitha palëve. Rekomandohet që procesi i edukimit dhe i trajnimit të realizohet në mënyrë të përshtatshme me kontekstin lokal dhe të përdorin metoda që sigurojnë informacion të kuptueshëm dhe të qartë për audiencën e synuar.

### Aksesueshmëria e informacionit

Për ta përcjellë informacionin tek individët me aftësi të kufizuara, intelektuale nevojitet përdorimi i një informacioni dhe komunikimi të përshtatshëm. Këto përfshijnë përdorimin e një gjuhe të thjeshtë dhe të kuptueshme, paraqitje në mënyrë të qartë dhe pa përdorur një terminologji të komplikuar. Pavarësisht se të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale dhe kujdestarët e tyre nuk kishin marrë pjesë në njoftime dhe në konsultime publike, ashtu sikurse për çështje të ndryshme ende infrastruktura dhe aksesueshmëria në informacion mbetet një sfidë për personat me aftësi të kufizuara. Profesionistët shprehen se në këtë drejtim ata përpiqen që t'i lehtësojnë dhe t'i ndihmojnë, sa munden, duke bërë të mundur që të ofrojnë shërbimin në kate të para apo të përdorin një gjuhë të thjeshtë dhe shumë të kuptueshme etj. Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë shpesh e konfirmojnë këtë qasje të profesionistëve, por ata theksojnë se kjo situatë është tejzgjatur, progresi është aq i ngadalhtë, sa mund të përkufizohet pothuaj inekzistent.

Në këto rrethana disa prej prindërve dhe kujdestarëve

shprehen pesimistë dhe theksojnë se i kanë humbur shpresat për zgjidhje të drejta dhe të duhura. Në këto kushte paraqitet e nevojshme, jo vetëm rritja e njohurive të tyre në lidhje me kuadrin ligjor dhe rregullator për njoftimin dhe konsultimin publik, por edhe angazhimi për të ndërgjegjësuar institucionet vendore, për të ofruar informacione të aksesueshme dhe të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale. Përdorimi dhe kombinimi i këtyre metodave dhe formave të informacionit të aksesueshëm është i rëndësishëm, për të siguruar që individët me aftësi të kufizuara, intelektuale të kenë mundësi të marrin informacionin dhe të komunikojnë efektivisht me botën përreth tyre.

### Sfidat teknologjike

Një pjesë e konsiderueshme e njoftimeve të konsultimeve publike bëhen në faqet e *web*-eve të institucioneve, nëpërmjet postës elektronike, regjistrit elektronik etj. Nga intervistat na rezultojnë se disa nga prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë nuk kanë gjithnjë akses në teknologjinë e nevojshme ose iu mungojnë aftësitë për t'i përdorur ato. Ata raportojnë se stili i jetesës dhe burimi i të ardhurave nuk iu krijojnë mundësi dhe hapësirë për të qenë familjarë me përdorimin e teknologjisë. Gjithashtu, prindërit dhe kujdestarët raportojnë se nuk kanë adresë të postës elektronike, nuk dinë të lundrojnë në *internet* për të kërkuar informacion në rrjetet sociale apo faqe të caktuara në *internet*.

### Llogaridhënia dhe transparencia

Organizatat jofitimprurëse ndihmojnë në sigurimin e transparencës në procesin legjislativ. Ato shpesh gjurmojnë ndryshimet e bëra në dokumentet e projektligjeve dhe verifikojnë, nëse shqetësimet e të rinjve me aftësi të kufizuara janë integruar, duke kërkuar përgjegjësi nga organet legjislative. Sipas ligjit, institucionet duhet të hartojnë raporte periodike në

lidhje me proceset e njoftimit, konsultimit dhe informimit të publikut, të cilat duhet të pasqyrojnë se si janë kryer proceset dhe si janë reflektuar dhe integruar rekomandimet dhe sugjerimet e palëve të interesit. Këto raporte ndodh të mos jenë të aksesueshme dhe jo të qarta në lidhje me mënyrën si janë kryer proceset. Ndërkohë, organizatat raportojnë se nuk kanë marrë ndonjë sqarim në lidhje me arsyet se përse kërkesat, sugjerimet apo rekomandimet e tyre nuk janë marrë në konsideratë. Roli i organizatave jofitimprurëse në procesin e njoftimit dhe konsultimit të dokumenteve të projektligjeve është i domosdoshëm, veçanërisht kur shihet nga objektivi i të rinjve me aftësi të kufizuara. Duke shërbyer si avokatë, lehtësues dhe vëzhgues, këto organizata sigurojnë që të drejtat, nevojat dhe perspektivat e këtyre individëve të rinj, jo vetëm të merren parasysh, por të integrohen në zemër të proceseve legjislativë.

### **Barrierat kulturore, sociale dhe besimi tek institucionet**

Në shoqërinë tonë pjesëmarrja dhe përfshirja proaktive në proceset e konsultimit publik dhe ato të vendimmarrjes ende stigmatizohen dhe nuk vlerësohen si funksionale dhe të besueshme. Kjo qasje reflektohet edhe te një pjesë e prindërve dhe kujdestarëve, kur u pyetën se çfarë mendimi kanë për një situatë hipotetike për pjesëmarrjen në proces konsultimi. Disa prej tyre shprehën mendimin se këto procese apo aktivitete bëhen “për të kaluar radhën”, “sa për të thënë”, “na pyesin dhe pastaj nuk na dëgjojnë” etj. Ata theksuan se opinionet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre nuk do të vlerësohen, duke çuar në hezitim në pjesëmarrje. Gjithashtu, qasja ndaj përqafimit të mendimit se institucionet i kryejnë proceset vetëm në mënyrë mekanike dhe se mendimet e tyre nuk merren në konsideratë, ndikon ndjeshëm besimin dhe qëndrimin ndaj pjesëmarrjes proaktive në proceset e konsultimit.



## Përfaqësim i kufizuar

Në Durrës dhe në Vlorë prindërit dhe kujdestarët shprehen se në qytetet e tyre ekzistojnë vetëm organizatat e personave me aftësi të kufizuara fizike. Në mënyrë të përsëritur ata theksuan shqetësimin e tyre për mungesën e organizatave jofitimprurëse për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale; situatë, e cila ndikon në ndërmarrjen e iniciativave të koordinuara, të qëndrueshme, rrjedhjen e informacionit apo edhe organizimin dhe prezantimin e shqetësimeve të tyre në një mënyrë të qartë, koncize dhe të mirë-strukturuar. Ata raportojnë se kjo situatë afekton nivelin e angazhimit të tyre, me besimin se nuk posedojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të tërhequr vëmendjen e politikë-bërësve dhe vendimmarrësve për të sjellë ndryshimet e nevojshme. Në këto rrethana ata ndjehen të papërfaqësuar dhe ndanë disa përvoja pozitive dhe të suksesshme, kur janë bërë pjesë e iniciativave të udhëhequra nga organizata, si *Ndihmoni Jetën* apo *ADRF*. Kërkesa dhe nevoja e tyre për të vepruar në formë të koordinuar është një tregues pozitiv, por sugjerohet që kjo çështje të eksplorohej më tej për të kuptuar barrierat dhe më pas për të vlerësuar mundësinë e diskutimit të alternativave dhe formave të reagimit me qëllim adresimin e nevojave të tyre.

---

## Roli i organizatave të aftësisë së kufizuar në zbatimin e ligjit dhe bashkëpunimi me prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara

---

Pjesëmarrja e të gjithë sektorëve të shoqërisë, veçanërisht e të rinjve me aftësi të kufizuara, në proceset legjislativë është thelbësore për sigurimin e ligjeve gjithëpërfshirëse. Organizatat jofitimprurëse luajnë një rol kryesor në tejkalimin e hendekut midis këtyre komuniteteve dhe organeve legjislativë.

Të rinjtë dhe kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara,

pavarësisht vetëdijes mbi rëndësinë e përfshirjes në proceset e hartimit të akteve ligjore, politike dhe rregullatore, raportojnë se në të shumtën e rasteve do të dëshironin që të ishin organizatat e aftësisë së kufizuar ato, të cilat të angazhoheshin në konsultimin dhe dhënien e *feedback*-ut. Nga këndvështrimi i tyre kjo qasje nuk nënkupton që ata të çlirohen nga pjesëmarrja dhe prezenca në këto aktivitete, madje theksojnë që dëshirojnë të jenë të pranishëm për të treguar interesin e tyre në lidhje me çështjet në fjalë, por ata shprehin dyshimin e fortë, nëse kanë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e duhura për të formuluar saktësisht dhe qartësisht qëndrimet e tyre. Kjo nevojë evidentohet si e rëndësishme në Bashkinë e Durrësit dhe të Vlorës, ku prindërit artikulojnë si shqetësuese mungesën e organizatave për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale.

### Avokimi dhe Përfaqësimi

Pjesëmarrësit në studim, kryesisht prindërit, por edhe profesionistët në institucionet e qeverisjes vendore, shprehin një besim të theksuar te roli i organizatave jofitimprurëse si avokatë të grupeve të ndryshme, vulnerable, përfshirë këtu edhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Me këtë qëndrim prindërit dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nuk synojnë që të shmangin prezencën dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e pjesëmarrjes publike, por besojnë se organizatat kanë kapacitetet e nevojshme që ta përforcojnë zërin e tyre, duke siguruar që nevojat, shqetësimet dhe përvojat e tyre të merren parasysh, kur hartohen dokumentet e projektligjeve. Prindërit në Tiranë, në Durrës dhe në Vlorë sollën në vëmendje shembullin e bashkëpunimit me organizatën *Ndihmoni Jetën* dhe ADRF, për të adresuar pranë qeverisjes vendore dhe qendrore çështje me interes të veçantë për ta dhe fëmijët e tyre.

## Njoftimi

Gjatë intervistave del qartë se organizatat jofitimprurëse në të shumtën e rasteve njoftohen në formë elektronike apo forma të tjera komunikimi në lidhje me pjesëmarrjen në procese konsultimi në qeverisjen vendore. Ato shprehen se marrin masat e nevojshme që të jenë të pranishme për të dhënë *feedback* me shkrim dhe të jenë aktive në takime. Gjithashtu, ato theksojnë se proceset shpesh karakterizohen vetëm nga një proces konsultimi, i cili nuk është i mjaftueshëm. Koha, që iu lihet në dispozicion, nuk i lejon që të marrin masa për t'u përgatitur sa dhe si duhet, për shkak të burimeve të pamjaftueshme, njerëzore. Draft-dokumentet për konsultim asnjëherë nuk janë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa organizatat, pavarësisht dëshirës dhe përpjekjeve, nuk i kanë burimet dhe kohën në dispozicion për të realizuar përshtatshmërinë e tyre për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale.

Pavarësisht prezencës dhe kontributit që ofrojnë organizatat, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit, kujdestarët e tyre jo gjithnjë marrin informacion nga organizatat në lidhje me këto procese konsultimi. Ata raportojnë se kryesisht janë ftuar në aktivitete për lançimin e këtyre dokumenteve sesa në procesin e hartimit, e përgatitjes së tyre.

## Platformat e konsultimit

Nga të gjitha intervistat vihet re qartazi mbështetja dhe kontributi i organizatave në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale. Prindërit, profesionistët dhe të rinjtë rendisin rolin e organizatave në bashkëpunimin për ngritjen e shërbimeve, trajnimin e tyre, pjesëmarrjen në iniciativa lobuese dhe advokuese. Ata shpesh kanë organizuar forume, seminare dhe fokus-grupe, duke ofruar një hapësirë të sigurt për të rinjtë me aftësi të kufizuara për të shprehur pikëpamjet e tyre pa

u ndikuar nga paragjykimet ose diskriminimi. Por, paraqitet nevoja për një përpjekje të shtuar për të organizuar dhe për të lehtësuar konsultimet në zbërthimin e zhargoneve komplekse, ligjore, duke e bërë më të lehtë për të rinjtë dhe kujdestarët e tyre të kuptuarit e proceseve ligjore dhe konsultimin e tyre.

### **Ngritja e kapaciteteve**

Organizatat jofitimprurëse luajnë një rol vendimtar në pajisjen e të rinjve me aftësi të kufizuara me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u angazhuar në mënyrë efektive në proceset legislative. Nga intervistat rezulton se të rinjtë dhe kujdestarët e tyre kanë marrë pjesë në një sërë trajnimesh të zhvilluara nga organizatat dhe qendrat që ata frekuentojnë. Trajnimet kanë një diapazon të gjerë, duke filluar nga jetesa e pavarur, ndërhyrja e hershme, të drejtat, integrimi, gjithëpërfshirja, por trajnimet nuk kanë patur në fokus sesione mbi të folurit në publik, të kuptuarit e terminologjive ligjore ose hartimin e dokumente ligjore dhe rregullatore, si dhe pjesëmarrjen e tyre në këto procese. Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë krahas interesit për të marrë pjesë shprehen se janë të interesuar për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre për t'u përfshirë dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive, jo vetëm në konsultimin e ligjeve, por edhe për mënyrën sesi ata të iniciojnë nevojën për ndryshime të kuadrit ekzistues, rregullator. Ata shprehen tejet të shqetësuar për mungesën e shërbimeve për të rinjtë dhe nevojën për ndërhyrje për ngritjen e tyre.

## Përfundime dhe rekomandime

*Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik* është i njohur nga profesionistët e institucioneve vendore, por elemente të tij, specifike duhet të trajtohen dhe të zhvillohen më tej, për të përmbushur me sukses misionin e tij, final. Ndërkohë, organizatat e aftësisë së kufizuar e njohin ligjin, por shprehen se qasja e zbatueshmërisë së tij nga institucionet e përmbush pjesërisht qëllimin e tij. Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nuk kanë njohuri në lidhje me *Ligjin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik*, por shprehen se kanë interes në pjesëmarrjen dhe përfshirjen aktive në proceset e njoftimit, hartimit dhe vendimmarrjes për ligje dhe dokumente rregullatore dhe politike, që i prekin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi.

Pjesëmarrësit në vlerësim nuk kanë qenë pjesëmarrës në ndonjë proces formal edukimi apo trajnimi, që lidhet në mënyrë specifike me njohjen apo zbatueshmërinë e *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik*. Ata shprehen se kanë marrë pjesë në trajnime në lidhje me të drejtat dhe pjesëmarrjen e tyre në procese të vendimmarrjes. Pavarësisht kësaj, këto trajnime nuk janë ndalur dhe nuk kanë trajtuar format dhe burimet e njoftimit, sipas këtij ligji, apo ekzistencën e regjistrit elektronik dhe çështje të tjera, që lidhen me të drejtat në frymën e ligjit.

Burimet mbizotëruese të njoftimit dhe të konsultimit të projekt-akteve të ndryshme, ligjore dhe politike realizohen në formë elektronike dhe ka raste edhe me shpalljen e njoftimeve në institucione. Duket se këto forma nuk njihen dhe nuk aksesohen nga prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë. Përdorimi i

teknologjisë dhe i internetit jo gjithmonë është i përshtatshëm për përdoruesit e shërbimeve, një pjesë e tyre nuk janë shumë familjarë, si rrjedhojë e aftësisë së tyre për të lundruar në internet për qëllime administrative apo edhe me burime të kufizuara, financiare, që kufizojnë aksesin.

Një çështje e përsëritur paraqitet aksesueshmëria në infrastrukturë dhe në informacion për personat me aftësi të kufizuara. Njoftimet dhe përmbajtja e dokumenteve nuk rezultojnë të jenë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Kjo situatë afekton në mënyrë të ndjeshme të gjitha hapat që lidhen me njoftimin, pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre, proaktiv.

Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në Bashkitë e Durrësit dhe të Vlorës nuk ndjehen të përfaqësuar, si rrjedhojë e mungesës së organizatave lokale për personat me aftësi të kufizuara. Ata ngrenë shqetësimin se, pavarësisht nevojës, dëshirës dhe angazhimit të tyre për shumë çështje ata nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të adresuar si duhet shqetësimet dhe problemet, të cilat janë të konsiderueshme.

Shoqëria jonë ende nuk e ka të konsoliduar qasjen proaktive të pjesëmarrjes në proceset e konsultimit publik dhe të vendimmarrjes. Organizatat, por më shumë prindërit dhe të rinjtë, shprehin një opinion dyshues dhe mosbesues për rezultatet e këtyre proceseve, duke afektuar cilësinë e pjesëmarrjes aktive dhe ndjekjes së procesit deri në vendimmarrjen finale.

Prindërit dhe kujdestarët e të rinjve me aftësi të kufizuara shprehin dëshirën dhe interesin që nga organizatat të përfshihen më shumë apo të mbahen të informuar gjatë proceseve të konsultimeve publike. Ata theksojnë se kanë nevojë të jenë më shumë të përfshirë dhe të angazhohen për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për familjarët e tyre.

Për të adresuar çështjet e mësipërme paraqitet e rëndësishme njohja, ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi formal me *Ligjin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik* me një qasje interaktive dhe të zbërthimit të rëndësisë së tij nga të gjitha palët e përfshira në proces. Burimet e njoftimit të informacionit duhet të realizohen, duke përdorur strategji komunikimi, të cilat garantojnë, jo vetëm mbërritjen e informacionit te palët e interesit, por edhe përmbajtjen e qartë të rëndësisë së pjesëmarrjes, krijimin e kohës në dispozicion dhe zhvillimin e një procesi konsultativ, i cili thellohet dhe analizon si duhet nevojat, shqetësimit dhe problemet e grupeve të interesit.

Institucionet vendore duhet që ta thellojnë bashkëpunimin me organizatat e aftësisë së kufizuar, për të zhvilluar ndërhyrje urgjente për përshtatjen e informacionit për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale, por jo vetëm. Për këtë mund të zhvillohen një sërë takimesh, ku të rrihen ide për përmirësimin e kësaj sfide të vazhdueshme. Në këto procese konsultative paraqitet e nevojshme që të thirren edhe prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.

Prindërit, kujdestarët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara duhen mbështetur, duhen lehtësuar dhe duhen fuqizuar që të pajisen me njohuri, aftësi dhe kompetenca për zhvilluar mekanizma reagimi proaktiv. Patjetër që strategjia nëpërmjet organizatave është mjaft efektive, por ata duhen të ndërgjegjësohen se ka edhe alternativa të tjera, si për shembull krijimi i rrjetit të prindërve, krijimi i grupeve vullnetare apo forumeve, të cilat jo domosdoshmërisht kërkojnë regjistrim në gjykatë apo angazhime shumë formale. Në këtë drejtim organizatat ekzistuese kanë përvojë dhe mund të kontribuojnë ndjeshëm.

Ndryshimi i sjelljes dhe i qëndrimit të anëtarëve apo grupeve të shoqërisë për besimin ndaj institucioneve apo edhe çështjeve të tjera është sfidues. Kjo kërkon një angazhim shumëplanësh

dhe gjithëpërfshirës, por hapat e para duhet të fillojnë me promovimin e rasteve të suksesit dhe diskutimin e hapur të përvojave negative me të gjithë aktorët.

Përmbledhtazi mund të konkludojmë se hartimi dhe miratimi i dokumenteve ligjore dhe politike, që respektojnë të drejtat dhe që pasqyrojnë nevojat reale është vështirë të realizohet pa bashkëpunimin mes të gjithave palëve, ndërtimin e besimit, pjesëmarrjen aktive, llogaridhënien dhe transparencën për hapat dhe procedurat e ndjekura për krijimin e tyre.



## Referenca

- Ligji nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore
- Ligji nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
- Ligji nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit
- VKM nr. 828/2015 Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike
- United Nations. (2006). Convention on the Rights of Persons with Disabilities (CRPD). Retrieved from <https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>
- Brown, T. et al. (2017). The Role of Information Access in Promoting Self-determination. Journal of Disability Research.
- Clark, M., & Murphy, G. (2017). Inclusive Education and Employment: The Role of Policy Consultation with Persons with ID. Disability Studies Quarterly.
- Davies, R. T., & Jenkins, R. (2021). Strategies for Inclusive Public Consultation. Journal of Inclusive Policy Making.
- Emerson, E., & Hatton, C. (2008). People with Learning Disabilities in England. Durham University.
- Gray, J., & Benson, M. (2019). Policy Formulation without Representation. Public Policy Quarterly.
- Iezzoni, L. I., & O'Day, B. L. (2006). More than Ramps: A Guide to Improving Health Care Quality and Access for People with Disabilities. Oxford University Press.
- Johnson, R., & Marks, A. (2020). Inclusive Policies: A Comprehensive Review. Inclusive Studies Journal.

- O’Leary, S., & Cole, M. (2021). The Perils of Stereotypes in Civic Participation. *Sociological Insights*.
- Peters, L., & Wilson, R. (2022). Opportunity Access and Intellectual Disabilities. *Global Disability Review*.
- Rodriguez, L., & Garcia, P. (2020). Seeking Equity in the Modern Age. *Equity Studies Quarterly*.
- Smith, J. (2018). Inclusive Decision-making and Civic Participation. *Democracy Journal*.
- Smith, E. L. (2020). Information Accessibility for Persons with Intellectual Disabilities. *Disability & Society Journal*.
- Stancliffe, R. J., Lakin, K. C., Larson, S., Taub, S., & Fortune, J. (2011). Overcoming Challenges to Community Engagement and Employment for People with Intellectual and Developmental Disabilities. *Intellectual and Developmental Disabilities*, 49 (6), 448-460.
- Turner, A., & Foster, L. (2018). History of Marginalization: Voices from the Past. *Historical Review Journal*.
- Turner, B. (2019). Participatory Policy Development and Persons with Intellectual Disabilities. *Public Policy Review*.
- Williams, E. (2019). Intellectual Disabilities: A Historical Perspective. *Disability History Quarterly*.
- Whyte, A., & Brodsky, A. (2018). Barriers to Participation for Individuals with Disabilities. *Journal of Disability Policy Studies*.

# Shtojca

## SHTOJCA – I

### Intervistë me profesionistë nga institucionet vendore

Faleminderit për kohën tuaj.

Emri im është \_\_\_\_\_.

Qëllimi i kësaj interviste është që të vlerësojë njohuritë, përvojën, perceptimin dhe qëndrimin tuaj lidhur me zbatimin e *Ligjit për Informimin dhe Konsultimin Publik* në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat publike dhe zhvillimin e politikave sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punësimit.

Intervista do të zgjasë rreth 30-45 minuta.

Përpara se të fillojmë intervistën, është e rëndësishme që të mbani në konsideratë, që mund ta ndaloni ose ta përfundoni intervistën në çdo kohë dhe gjithashtu mund të refuzoni t'i përgjigjeni pyetjeve, që nuk dëshironi. Informacioni nga intervista juaj do të përdoret vetëm për një raport vlerësimi që shoqata *Ndihmoni Jetën* po kryen në kuadër të një projekti të mbështetur nga programi *Askush të mos mbetet pas/Leave No one Behind*, Shqipëri.

Të dhënat anonime do të ndahen vetëm me shoqatën *Ndihmoni Jetën*. Për mua si vlerësuese dhe shoqatën *Ndihmoni Jetën* është me të vërtetë e rëndësishme, që pjesëmarrësit në vlerësim të ndihen mirë gjatë intervistës dhe të jenë plotësisht të sigurtë për përvojat dhe perceptimet e tyre. Nëse ka ndonjë përgjigje, që mund të jetë e identifikueshme, ne do të kërkojmë

lejen tuaj, përpara se t'i përdorim ato. Ju lutem, më njoftoni, nëse keni ndonjë pyetje se si do të përdoren të dhënat tuaja; ju gjithashtu mund të ankoheni pranë organizatës *Ndihmoni Jetën*, nëse keni ndonjë problem me mënyrën e trajtimit të të dhënave tuaja, bazuar në ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me *Ligjin nr. 120/2014 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*.

Ky është informacioni kryesor, përmbledhës - më duhet vetëm t'ju bëj disa pyetje përfundimtare në lidhje me pëlqimin dhe më pas mund të fillojmë me vetë intervistën.

A jepni pëlqimin tuaj për të marrë pjesë në këtë intervistë?  
Po/Jo

Do të doja ta regjistroja këtë bisedë për shënimet e mia; regjistrimi do të fshihet së bashku me transkriptin 6 muaj pas përfundimit të projektit. Ju lutem, më tregoni, nëse gjithçka është në rregull. Nëse po, a më jepni lejen tuaj që të filloj regjistrimin?

Së fundi, a keni ndonjë pyetje, përpara se të fillojmë?

### **Të dhëna demografike**

Institucioni .....

Pozicioni .....

Mosha .....

Gjinia.....

Arsimi .....

Profesioni .....

Përvoja në punë gjithsej .....

Përvoja e punës në këtë pozicion .....

1. A mund ta përshkruani shkurtimisht rolin tuaj në zbatimin e *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik*?
2. Çfarë strategjish janë vendosur në nivel lokal për të siguruar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në dëgjesat publike dhe zhvillimin e politikave?
3. Cilat forma të informacionit të aksesueshëm ose metodave të komunikimit po përdoren për të përcjellë informacionin tek individët me aftësi të kufizuara, intelektuale?
4. Si po e vlerësoni efektivitetin e këtyre metodave për sa i përket të kuptuarit dhe përdorimit të tyre nga personat me aftësi të kufizuara, intelektuale?
5. A mund të jepni shembuj se si kontributi i personave me aftësi të kufizuara, intelektuale ka ndikuar në zhvillimin e politikave lokale, sociale/shëndetësore/arsimore dhe të punësimit?
6. Çfarë lloj trajnimi iu është ofruar nëpunësve publikë dhe palëve të tjera të interesuara për t'i ndihmuar ata të angazhohen në mënyrë efektive me individët me aftësi të kufizuara, intelektuale?
7. A ka ndonjë mekanizëm reagimi të vendosur për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi efektivitetin e zbatimit të këtij ligji?
8. Si po përfshihen mendimet e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në përmirësime apo ndryshime në politika dhe në praktikë?
9. Cilat sfida apo barriera janë hasur në zbatimin e këtij ligji në nivel vendor?
10. A mund të jepni shembuj të ndonjë akomodimi të bërë për të lehtësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat dëgjimore, publike?
11. Çfarë hapash po ndërmerren për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin e publikut për ligjin dhe të drejtat e personave

me aftësi të kufizuara, intelektuale?

12. Si po punon institucioni juaj me OJQ-të dhe aktorët e tjerë në zbatimin e këtij ligji?
13. Çfarë masash po përdoren për të monitoruar dhe për të vlerësuar rregullisht rezultatet e zbatimit të këtij ligji?
14. Si po i trajtoni barrierat e identifikuar për të përmirësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale?
15. A mund të diskutoni ndonjë histori suksesi apo fushë përmirësimi si rezultat i zbatimit të këtij ligji?

## SHTOJCA – II

### Intervistë me përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar

Faleminderit shumë për kohën tuaj sot.

Emri im është \_\_\_\_\_.

Qëllimi i kësaj interviste është që të vlerësojë njohuritë, përvojën, perceptimin dhe qëndrimin tuaj lidhur me zbatimin e *Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik* në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat publike dhe zhvillimin e politikave sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punësimit.

Intervista do të zgjasë rreth 30-45 minuta.

Përpara se të fillojmë intervistën, është e rëndësishme që të mbani në konsideratë, që mund ta ndaloni ose ta përfundoni intervistën në çdo kohë dhe gjithashtu mund të refuzoni t'i përgjigjeni pyetjeve, që nuk dëshironi. Informacioni nga intervista juaj do të përdoret vetëm për një raport vlerësimi që shoqata *Ndihmoni Jetën* po kryen në kuadër të një projekti të mbështetur nga programi *Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind*, Shqipëri.

Të dhënat anonime do të ndahen vetëm me shoqatën *Ndihmoni Jetën*. Për mua si vlerësuese dhe shoqatën *Ndihmoni Jetën* është me të vërtetë e rëndësishme, që pjesëmarrësit në vlerësim të ndihen mirë gjatë intervistës dhe të jenë plotësisht të sigurtë për përvojat dhe perceptimet e tyre. Nëse ka ndonjë përgjigje, që mund të jetë e identifikueshme, ne do të kërkojmë lejen tuaj, përpara se t'i përdorim ato. Ju lutem, më njoftoni, nëse keni ndonjë pyetje se si do të përdoren të dhënat tuaja; ju gjithashtu mund të ankoheni pranë organizatës *Ndihmoni Jetën*, nëse keni ndonjë problem me mënyrën e trajtimit të të dhënave

tuaja, bazuar në ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me *Ligjin* nr. 120/2014 për *Mbrojtjen e të Dhënave Personale*.

Ky është informacioni kryesor, përmbledhës - më duhet vetëm t'ju bëj disa pyetje përfundimtare në lidhje me pëlqimin dhe më pas mund të fillojmë me vetë intervistën.

A jepni pëlqimin tuaj për të marrë pjesë në këtë intervistë?  
Po/Jo

Do të doja ta regjistroja këtë bisedë për shënimet e mia; regjistrimi do të fshihet së bashku me transkriptin 6 muaj pas përfundimit të projektit. Ju lutem, më tregoni, nëse gjithçka është në rregull. Nëse po, a më jepni lejen tuaj që të filloj regjistrimin?

Së fundi, a keni ndonjë pyetje, përpara se të fillojmë?

### **Të dhëna demografike**

Pozicioni .....

Mosha .....

Gjinia.....

Arsimi .....

Profesioni .....

Përvoja në punë gjithsej .....

Përvoja e punës në këtë pozicion

1. A mund të përshkruani shkurtimisht misionin dhe objektivat kryesore të organizatës tuaj?
2. Prej sa kohësh organizata juaj është duke operuar në fushën e aftësisë së kufizuar dhe në cilën/cilat zona gjeografike?



3. A jeni njohur ju dhe organizata juaj me *Ligjin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik*?
4. Nëse po, si e morët vesh për të? Nëse jo, intervistuesja prezanton dhe përshkruan ligjin në fjalë dhe shpjegon disa elemente të tij, kryesore.
5. Çfarë kanalesh ose burimesh përdorni zakonisht për të qëndruar të informuar për ligje apo përditësime të tilla?
6. Në gjykimin tuaj, sa i rëndësishëm është ky ligj për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë më specifike për të rinjtë me aftësi të kufizuara, intelektuale?
7. Bazuar në përvojën tuaj, si e percepton publiku i gjerë, veçanërisht komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, këtë ligj?
8. A besoni se ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm për këtë ligj te personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët, kujdestarët e tyre?
9. Si angazhohet ose merr pjesë organizata juaj në proceset e konsultimit publik në lidhje me projekt-akte, rregulla apo politika të ndryshme?
10. A mund të ndani një përvojë, ku organizata juaj është përfshirë në mënyrë aktive në një proces të tillë konsultimi?
11. A ka sfida apo barriera, me të cilat përballeni, kur përpiqeni të angazhoheni në iniciativat e konsultimit publik?
12. Nga këndvështrimi juaj, sa efektivisht po zbatohet *Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik* në bashkinë ku ju operoni, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara? A ka aspekte apo dispozita specifike brenda ligjit, që besoni se nuk po zbatohen sa duhet?
13. A ka ndërmarrë OJQ-ja juaj ndonjë masë apo iniciativë specifike, për të siguruar që dispozitat e këtij ligji të zbatohen apo të promovohen siç duhet?
14. Çfarë sugjerimesh apo strategjish do të rekomandonit

për të rritur zbatimin dhe ndërgjegjësimin e këtij ligji në rajonin tuaj?

15. Si mund të bashkëpunojnë më mirë institucionet vendore apo organizata të tjera, për të përforcuar përfitimet e ligjeve të tilla?
16. A keni ndonjë koment ose këndvështrim që dëshironi të shtoni apo të ndani në lidhje me këtë temë?

Faleminderit për kohën dhe ndarjen e njohurive, mendimeve dhe opinioneve tuaja.

## SHTOJCA – III

### Intervistë me prindër/kujdestarë të të rinjve me aftësi të kufizuara, intelektuale

Faleminderit shumë për kohën tuaj sot.

Emri im është \_\_\_\_\_.

Qëllimi i kësaj interviste është që të vlerësojë njohuritë, përvojën, perceptimin dhe qëndrimin tuaj lidhur me zbatimin e *Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik* në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, intelektuale në seancat publike dhe zhvillimin e politikave sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punësimit.

Intervista do të zgjasë rreth 30-45 minuta.

Përpara se të fillojmë intervistën, është e rëndësishme që të mbani në konsideratë, që mund ta ndaloni ose ta përfundoni intervistën në çdo kohë dhe gjithashtu mund të refuzoni t'i përgjigjeni pyetjeve, që nuk dëshironi. Informacioni nga intervista juaj do të përdoret vetëm për një raport vlerësimi që shoqata *Ndihmoni Jetën* po kryen në kuadër të një projekti të mbështetur nga programi *Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind*, Shqipëri.

Të dhënat anonime do të ndahen vetëm me shoqatën *Ndihmoni Jetën*. Për mua si vlerësuese dhe shoqatën *Ndihmoni Jetën* është me të vërtetë e rëndësishme, që pjesëmarrësit në vlerësim të ndihen mirë gjatë intervistës dhe të jenë plotësisht të sigurtë për përvojat dhe perceptimet e tyre. Nëse ka ndonjë përgjigje, që mund të jetë e identifikueshme, ne do të kërkojmë lejen tuaj, përpara se t'i përdorim ato. Ju lutem, më njoftoni, nëse keni ndonjë pyetje se si do të përdoren të dhënat tuaja; ju gjithashtu mund të ankoheni pranë organizatës *Ndihmoni Jetën*, nëse keni ndonjë problem me mënyrën e trajtimit të të dhënave

tuaja, bazuar në ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me *Ligjin* nr. 120/2014 për *Mbrojtjen e të Dhënave Personale*.

Ky është informacioni kryesor, përmbledhës - më duhet vetëm t'ju bëj disa pyetje përfundimtare në lidhje me pëlqimin dhe më pas mund të fillojmë me vetë intervistën.

A jepni pëlqimin tuaj për të marrë pjesë në këtë intervistë?  
Po/Jo

Do të doja ta regjistroja këtë bisedë për shënimet e mia; regjistrimi do të fshihet së bashku me transkriptin 6 muaj pas përfundimit të projektit. Ju lutem, më tregoni, nëse gjithçka është në rregull. Nëse po, a më jepni lejen tuaj që të filloj regjistrimin?

Së fundi, a keni ndonjë pyetje, përpara se të fillojmë?

### **Të dhëna demografike**

Mosha .....

Gjinia.....

Arsimi .....

Profesioni .....

Prej sa kohësh jetoni në Durrës/Tiranë/Vlorë? .....

1. A jeni në dijeni të *Ligji i Njoftimit dhe Konsultimit Publik*?
  - Nëse po, si e morët vesh për të? (*Nëse jo, intervistuesja bën një përmbledhje të ligjit dhe elementëve të tij, përberës.*)
2. A mund të shpjegoni me fjalët tuaja, çfarë kuptoni me këtë ligj? A ka dispozita specifike brenda këtij ligji, që ju i konsideroni veçanërisht të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara?

3. Si do ta vlerësonit rëndësinë e këtij ligji për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në një shkallë nga 1-10, ku 10 është jashtëzakonisht e rëndësishme?
4. A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi këtë ligj apo të drejtën tuaj për t`u njoftuar dhe për t`u konsultuar në lidhje me hartimin e akteve të ndryshme, rregullatore, ligjore dhe politike për personat me aftësi të kufizuara?
5. Cili është mendimi dhe/apo përvoja juaj për mënyrën se si institucionet vendore (bashkia, shëndetësia, shkollat dhe zyrat e punës) i adresojnë nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? (*Intervistuesi ndalet, për të grumbulluar informacion për secilin sektor më vete.*)
6. A besoni se pushteti vendor (bashkia, shëndetësia, shkollat dhe zyrat e punës) po bën mjaftueshëm për të ndërgjegjësuar prindërit si ju për këtë ligj? (*Intervistuesi ndalet, për të grumbulluar informacion për secilin sektor më vete.*)
7. A keni qenë ndonjëherë ju ose anëtarë të tjerë të familjes tuaj pjesë e një procesi konsultimi publik në lidhje me projekt-akte, rregullore apo politika që prekin direkt apo indirekt personat me aftësi të kufizuara?
  - Nëse po, a mund ta përshkruani përvojën?
  - Nëse jo, a ka ndonjë arsye të veçantë?
8. Çfarë pengesash, nëse ka, hasni në pjesëmarrjen në këto procese të konsultimit publik?
9. Në një skenar ideal, si do të dëshironit të përfshiheshit në konsultimet publike? (Për shembull: takime me komunitetin, takime në grupe të vogla, sondazhe nëpërmjet telefonit ose postës elektronike etj.)
10. Sa efektiv mendoni se ka qenë pushteti vendor (bashkia, shkollat, qendrat shëndetësore, zyrat e punës) në zbatimin e dispozitave të këtij ligji?
11. A ka fusha apo dispozita specifike brenda ligjit, që besoni

se nuk po zbatohen në mënyrë efektive?

12. A keni vërejtur ndonjë përmirësim apo ndryshim në konsultimin publik dhe në shpërndarjen e informacionit, që nga miratimi i këtij ligji?
13. Çfarë sugjerimesh apo rekomandimesh do t'i jepnit institucioneve të pushtetit vendor për të përmirësuar procesin e informimit dhe të konsultimit për personat me aftësi të kufizuara, intelektuale?
14. A ka aspekte të tjera, që lidhen me të drejtat e aftësisë së kufizuar dhe konsultimin publik, që mendoni se pushteti vendor duhet t'i trajtojë?
15. A ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi të ndani apo ndonjë mendim tjetër që keni për këtë temë?

*Faleminderit për kohën, ndarjen e informacionit dhe mendimet tuaja.*

## SHTOJCA – IV

Përschendetje!

Unë jam \_\_\_\_\_ dhe po punoj me shoqatën *Ndihmoni Jetën*, që mbështet dhe ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Ne dëshirojmë të mësojmë se çfarë dini dhe mendoni për mënyrën se si bashkia dhe institucione të tjera në qytetin tuaj bisedojnë dhe kërkojnë mendimet tuaja, kur përgatisin ligje dhe rregulla të ndryshme. Unë do t'ju bëj disa pyetje, por ju vendosni t'i përgjigjeni ose mos t'i përgjigjeni. Jemi shumë të interesuar të dimë mendimin tuaj për pyetjet që do t'ju bëj.

Kjo bisedë do të jetë e shkurtër, rreth 30 minuta. Gjithçka që thoni, do të jetë private dhe ne nuk do t'ia tregojmë askujt përgjigjet tuaja, specifike.

1. Sa vjeç jeni?
2. Çfarë ju pëlqen të bëni në kohën tuaj të lirë?
3. Sa kohë keni që jetoni në Tiranë/Durrës/Vlorë?
4. Keni dëgjuar për një rregull, që thotë se, kur institucionet në qytetin tuaj duan të përgatisin ligje dhe rregulla, ato duhet t'ju lajmërojnë, që të bisedojnë me ju apo të kërkojnë mendim nga ju?
  - Nëse po, a mund të na tregoni se si keni dëgjuar për të?
5. A mendoni se është e rëndësishme që bashkia/shkolla, shëndetësia/zyra e punës të kërkojë mendime dhe të ndajë informacione me personat me aftësi të kufizuara?
  - A mund të na thoni, pse?
6. Si ndiheni, kur mendoni për bashkinë/shëndetësinë/shkollat/zyrat e punës? Si i ndihmojnë apo i dëgjojnë ata personat me aftësi të kufizuara?

7. A keni biseduar ndonjëherë me dikë nga bashkia apo keni qenë ndonjëherë pjesë e një grupi, ku ju kanë kërkuar mendimet apo opinionet tuaja për një çështje?
  - Nëse po, a mund të na tregoni për këtë? Ishte një përvojë e mirë?
  - Nëse jo, është në rregull. Por, do të dëshironit të ishit pjesë e bisedave të tilla?
8. A ka vështirësi për ju që t'iu bashkoheni këtyre bisedave apo të jepni mendimet tuaja?
9. Nëse do të mund të zgjidhnit, si do të dëshironit t'i ndanit mendimet tuaja? (Për shembull: me anë të vizatimit, bisedës në grupe të vogla, përgjigjes së pyetjeve në kompjuter.)
10. A keni ndonjë këshillë për bashkinë/shkollën/shëndetësinë/zyrën e punës se si të bisedojnë apo të përfshijnë të rinj si ju, kur bëjnë ligje dhe rregulla të ndryshme?
11. A ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi të ndani me ne?

*Faleminderit shumë që folët me ne. I vlerësojmë vërtet mendimet tuaja!*